

20180110111

L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KULTURË

Neni 1

Në Ligjin për kulturë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15 dhe 39/16), në nenin 11-b paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"Artisti dhe punëtori profesional nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, i cili ka realizuar të drejtë të pensionit dhe i cili është fitues i njërit prej çmimeve në vijim për sferën e kulturës dhe artit:

- çmimi republikan, përkatësisht shtetëror "11 Tetori" ose
- çmimi republikan, përkatësisht shtetëror "Shën Kliment Ohridski" ose
- çmimi shtetëror "23 Tetori", ka të drejtë të kompensimit mujor me para në lartësi të dallimit ndërmjet pensionit që e realizon dhe shumës prej 38.500 denarësh."

Neni 2

Në nenin 29 në paragrafi (3) pika 4) ndryshohet si vijon:

"ka minimum pesë vjet stazh pune në sferën e kulturës ose pesë vjet përvojë pune në punë ose projekte në sferën e kulturës në bazë të marrëveshjeve të lidhura për vepër;"

Neni 3

Në nenin 31 - a paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) shlyhen.

Në paragrafin (5) para fjalës "Rrogën" numri (5) shlyhet.

Neni 4

Në nenin 31-b në paragrafin (2) fjalët: "gjashtë muajt e ardhshëm" zëvendësohen me fjalët: "afat i përcaktuar nga ministri i Kulturës i cili nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muajt".

Në paragrafin (3) fjalët "gjashtë muajt" zëvendësohen me fjalët: "afati nga paragrafi (2) i këtij neni".

Neni 5

Në nenin 34 paragrafët (1) dhe (4) fjala "konkurs" zëvendësohet me fjalët: "shpallje publike".

Neni 6

Në nenin 84 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Drejtori i institucionit, përkatësisht personi përgjegjës në subjektin e mbikëqyrjes është i detyruar që t'i mundësojë inspektorit shikim në gjendjen, punën dhe aktet dhe t'ia japë të dhënat dhe njoftimet e kërkuara."

Në paragrafin (3) i cili bëhet paragraf (4) fjalët: "procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë" zëvendësohen me fjalët: "shkallë të dytë nga sfera e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse."

Neni 7

Në nenin 91 paragrafi (1) në alinenë 1 numri "25" zëvendësohet me numrin "28".

Neni 8

Në nenin 91 - a në paragrafin (1) në alinenë 11 fjalët: "86 paragrafi (1)" zëvendësohen me fjalët: "84 paragrafi (3)".

Pas alinesë 11, shtohet aline e re 12, si vijon:

“ - nuk i merr masat dhe aktivitetet përkatëse për mënjanimin e parregullsive në afatin e përcaktuar (neni 85 pika 1)).”.

Neni 9

Artistëve dhe punëtorëve profesionalë nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji e kanë realizuar të drejtën e kompensimit mujor me para në lartësi të dallimit ndërmjet pensionit që e realizojnë dhe pensionit më të lartë në Republikën e Maqedonisë në vitin paraprak, për vitin rrjedhës pas ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojë që t'u paguhet kompensimi mujor me para në pajtim me nenin 11-b nga Ligji për kulturë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15 dhe 39/16).

Neni 10

Personi i cili e ka marrë titullin artist nacional, e me këtë edhe të drejtën e kompensimit mujor me para në pajtim me Ligjin për artist nacional të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë ” numër 44/11) deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse pas ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji e merr ndonjërin nga çmimet nga neni 1 të këtij ligji, e njëjta e përjashton të drejtën e shfrytëzimit njëkohësisht të kompensimit mujor me para nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 11

Procedurat e filluara pas kërkesës së parashtruar për realizimin e kompensimit mujor me para nga neni 1 i këtij ligji deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundohen në pajtim me këtë ligj.

Neni 12

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për kulturë.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".